

Intervista

Dr. Mehmet Xheka, kandidat i PD-së për kryetar bashkie në Berat

Kush është z. Mehmet Xheka?

Mehmet Xheka, u lindi më 8.11.1950. Shkollën e mesme e mbarova më 1968 në gjimnazin “Babë Dudë Karbunara” me mesatare 10-të. Në shtator 1968 fillova studimet e larta pranë Universitetit të Tiranës, në fakultetin e mjekësisë. Jam diplomuar në qershor të vitit 1973, me titullin mjek i përgjithshëm, me rezultate të shkëlqyera.

Vijon në faqen 2

Z. Fadil Nasufi, kandidat i PS-së për kryetar bashkie në Berat.

Deri në çastet e fundit opinioni shihet si konkurentin tuaj kryesor për kryetar bashkie kryetarin e degës së PD-së z. Dritan Haznedari. Si ndiheni përballë një surprize si kandidatura e Dr. Mehmet Xhekës?

Vijon në faqen 2

Elegji

Në cilin gjyq je nisur, or qyq?

Në cilin gjyq je nisur, or qyq?
Me dorën e majtë atje bëhet kryq!
Këtej gjeraqina, andej rri skifteri,
Në mes larashi i ftohtë si mermeri.

Në cilin gjyq je nisur, or qyq?
Ku gurët e zinj po rrinë këmbëkryq?
Ku fytyrëmurrëtiesit ecin serbes
Me celularë si vezme në brez?

Në cilin gjyq je nisur, or qyq?
Po atje vendimi pritet me muq!
Ah, veç paraja me dymbëdhjetë yje
Është spata që çan ndër ato pyje!

Në cilin gjyq je nisur, or qyq?
Atje shkohet veç me sëndyq!
Dhe po pate sëndyq të Turqisë
Ti i luan fenë gjithë drejtësisë!

Në cilin gjyq je nisur, or qyq?
Atje me gjithë rroba të përlejshme, këlltuq!
Ja, mbi ligj, kanë shkruar serbes:
Paraja e bardhë për ditën e zezë!

Në cilin gjyq je nisur, or qyq?
Ecën e rri, e rri duarkryq.
Dhe kur ata do të thonë: Rrëfeu!
Ti do t’u thuash: “T’ia tregoj dheut!”

Nga folku i sotëm

Intervistë me
Dr. Mehmet Xhekën,

vijon nga faqja 1

kandidat i PD-së për kryetar bashkie në Berat

Fillova punë si mjek pranë spitalit civil në Berat, ku punova 2 vjet. Në qershor 1976 transferohem në qendrën shëndetësore të fshatit “Fushë -Peshtan”, me detyrën e mjekut të zonës, ku punova 3 vjet. Rikthehem sërish pranë spitalit civil Berat. Fitova të drejtën e specializimit në fushën e kardiologjisë. Në shtator ’79 -mars ’81 kam kryer specializimin në klinikën kardiologjike të Tiranës dhe fitova titullin mjek kardiolog me rezultate të larta. Kam mbrojtur të gjithë provimet pasuni-versitare, kam mbrojtur me dëshmi gjuhën angleze pranë Universitetit të Tiranës, fakulteti i gjuhëve të huaja. Kam marrë pjesë në disa konferenca kardio-logjike ndërkombëtare. Jam anëtar i shoqatës kardiologjike. Jam trajnuar në universitetet ndër-kombëtare si Ankara, në kujdesin primar shëndetësor (pajisur me dëshmi kualifikimi). Kam punuar si drejtor i shëndetit publik në Berat, kam kryer detyrën e shefit të shërbimit të sëmundjeve të brendshme prej vitit 96-98. Aktualisht ushroj profesionin e mjekut kardiolog pranë spitalit rajonal të Beratit.

Jeni kandidatura e PD-së, partisë më të madhe opozitare. Cila është rruga e përzgjedhjes suaj deri këtu?

Mendoj që ushtrimi i profesionit të mjekut për një kohë të gjatë ka bërë që të kem një integritet profesional të gjerë në qytet. Ajo që është më kryesore, bindjet e mia liberaldemokrate të shprehura hershëm dhe qartë në çdo mjedis, kanë ndikuar në përzgjedhjen time.

Kandidati i një force të madhe politike, siç është PD, mbart tek vetja mentalitetin politik, shoqëror të grupimit politik. Cilat janë lidhjet me PD-në dhe të djathtën në përgjithësi?

Unë e thashë edhe më sipër që konceptet e mia për zhvillimin e shoqërisë janë liberaldemokracia. Mendoj që kjo është lidhja më e fortë që kam me PD-në në veçanti dhe të djathtën në përgjithësi.

Vizioni juaj si kryetar i Bashkisë së Beratit

Do të punoj që Beratit t'i jap shkëlqimin që meriton, për një Berat vlerash që i kanë dhënë brezat, për një Berat me më shumë investime, me sa më shumë shërbime për qytetarët, një Berat me kulturë, arsime e sporte të zhvilluara, ku të argëtohet e zhvillohet brezi i ri, një Berat të pastër, të gjelbëruar e të ndriçuar, një Berat turistik.

Që të fitosh kreun e Bashkisë, përveç votave të PD-së dhe aleatëve të saj, duhen edhe mjaft vota “të shumicës së heshtur”. Si do ta ofroni këtë votues?

Formulimi i pjesës së parë të pyetjes nuk do të më pëlqente, sepse bie ndesh me qëllimin e kandidatimit tim. Kandidimi dhe fitimi i vendit të kryetarit të Bashkisë së Beratit për mua nuk është një qëllim, thjesht për t'u ulur në një poltron, ashtu si thoni ju. Ai poltron, që në pamje të parë duket aqë i butë, për konceptin e përgjegjësive që ka, e shoh fare të parehatshëm. Përsa i takon pjesës së dytë të pyetjes, e vlerësoj shumë të saktë dhe them se çdo votë ka rëndësi për fitoren. Mënyra se si do të realizoj fushatën, do të bëjë të mundur fitimin e atyre votave, por edhe shumë të tjera.

Cilat janë shinat mbi të cilat do të lëvizë fushata juaj elektorale? Puna juaj në fushatën elektorale

Baza e kryerjes së fushatës elektorale do të jetë programi dhe alternativa e forcës që unë përfaqësoj. Ai program dhe ato alternativa, do të përshtaten dhe konkrete-tizohen me problemet, shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve të Beratit. Kontaktet që kam pasur dhe kam me elektoratin, bëjnë të mundur që të njoh shumë mirë se ç'kërkojnë ata nga kryetari i Bashkisë, cilat janë kërkesat e tyre në emegjencë dhe në prognozë. Të gjitha këto do të bëjnë drejtimin e fushatës, e cila mbi të gjitha do të jetë e sinqertë, pa demagogji, pa premtime boshe dhe pa angazhime që nuk realizohen.

Një koment për konkurentët tuaj?

Kam njohje të hershme me konkurentët e shpallur dhe ata që janë shprehur. Vlerësoj dhe respektoj kandidaturat që kanë dalë përballë meje. Unë në këtë garë kam hyrë për të fituar.

“Lajmëtari”

Intervistë me z. Fadil Nasufi,
kandidat i PS-së për kryetar bashkie në Berat.

vijon nga faqja 1

Kandidatura e Dr. Mehmet Xhekës është një zgjedhje që ka bërë PD-ja. Për mua nuk përbën ndonjë surprizë, përveç faktit që Dr. Mehmet Xheka ka qenë në periferi të zhvillimeve politike, kryesisht i paangazhuar në parti, me afeksione të ndjeshme nga e majta dhe me lidhjet e njohjet që të jep profesioni i mjekut. Kam përshtypjen se edhe vetë është i pavendosur për përgjegjësinë elektorale që ka marrë përsipër sepse ndihet i tronditur midis privilegjit që të jep profesioni i kardiologut në Shqipëri dhe ekzaltimit që të jep Amerika. Besoj se me Dr. Xhekën dhe kandidatët e tjerë do të zhvillojmë një fushatë elektorale të civilizuar, demokratike dhe miqësore, larg tensioneve e konflikteve që shkakton politika në përgjithësi.

Krahas mesazheve që do të përcillni tek elektorati për të fituar simpatinë e tij, keni edhe një faturë të qeverisjes vendore nga Partia Socialiste. Cila është përmbajtja e kësaj fature sipas mendimit tuaj?

Elektorati do të na votojë edhe për punën tonë të kryer në këta tre vjet të qeverisjes vendore. Midis ambicieve dhe mundësive, midis dëshirave dhe realiteteve, midis shanseve dhe arritjeve, gjithmonë kanë prioritet të parat. Unë mendoj se cikli 3-vjeçar i këtij mandati të qeverisjes vendore mbyllet me sukses, për t'i hapur rrugën një etape të re që të shënojë progres në të gjithë drejtimet dhe interesat e komunitetit. Kur je në pushtet do të kesh edhe konsum. Ajo që ju e quani faturë ose kosto, për mua dhe PS-në janë problemet ekonomike e sociale të qytetarëve, kërkesat dhe interesat e tyre në rritje për zhvillim, zgjidhja përfundimtare e problemeve për energji, ujë të pijshëm, të infrastrukturës, krijimi i hapësirave për punësim, rritje të mirëqenies ekonomike etj. Rëndësi ka që problemet dhe shqetësimet që kanë njerëzit t'i njohësh, t'i vlerësosh dhe t'i zgjidhësh sa më shpejt të jetë e mundur.

Imazhi juaj për Bashkinë e Beratit, shkurtimisht

Historia, tradita, vlerat arkitekturore e muzeale, kultura dhe qytetaria beratase meritojnë vëmendje dhe angazhim që Berati të jetë një qytet që t'i rriten vlerat dhe emri nga puna jonë, nga puna e të gjithëve. Unë jam i kandiduar nga Partia Socialiste, por jam i motivuar nga madhështia e qytetit të Beratit, ndaj do të kem përkushtimin dhe kurajon për të vepruar, për të punuar, e për të realizuar programin elektorale për gjerat më thelbësore e më jetike që ka komuniteti. Në thelb, imazhi im për Bashkinë e Beratit, është imazh pune, ndërtimi, zhvillimi, bashkëpunimi e partneriteti. Janë të ftuar të gjithë të kontribuojnë për zhvillimin e qytetit tonë.

A do të ndikojë polemika e ashpër brenda PS-së në rezultatin e saj në zgjedhjet vendore të 12 tetorit?

Nga sherri dhe konflikti politik, askush nuk përfiton, përkundrazi, PS është mësuar me debate të tilla, por besoj se tani ka një tejkalim mase. Në PS nuk duhet të ketë dy grupe, dy vija, ku njëra qeveris e tjetra bën opozitën. Elektorati socialist duhet të ruajë qetësinë dhe maturinë, për të mos u ndikuar nga polemikat në leadershipin e PS. Të gjithë drejtuesit dhe aktorët e politikës qëndrojnë mbi supet dhe shpatullat e socialistëve, ndaj janë të interesuar që baza e PS të jetë solide e kompakte. Grupet rivalizojnë njëri-tjetrin, por të gjithë mbyten në detin e madh të socialistëve shqiptarë. Kjo pyetje më jep rastin që t' u bëjë thirrje socialistëve dhe elektoratis tonë që të mos lëkundet në bindjet e tij nda PS-së dhe të votojë për PS-në e kandidatët e saj, për ato vlera dhe arritje që na bashkojnë.

Midis PD-së dhe PS-së ka një hapësirë që sa vjen e zgjerohet. Pse mendoni se duhet të votojnë për kandidaturën tuaj këta qytetarë të pazotuar?

Me kënaqësi konstatoj se në Berat nuk ka agresivitet dhe konfliktualitet të ashpër politik midis PS-së e PD-së. Lufta politike dhe debati kryesisht janë të fokusuar në zgjidhjen e kërkesave të njerëzve, për efikasitetin e qeverisjes dhe për ballafaqimin e alternativave konkurruese. Ky shtrat normal dhe raport njerëzor e politik marrëdhëniesh i ka zgjeruar hapësirat e komunikimit politik. Për sa i përket sjelljes elektorale të njerëzve të paangazhuar në politikë, unë mendoj se duhet ta mbështesin kandidaturën time, sepse më njohin, më kanë provuar në detyrën time si kryetar i PS-së së Beratit. Kush beson në ndershmërinë time, në aftësitë e mia dhe në forcën time politike, le të më votojë! Megjithatë, fushata është përpara dhe ne do të komunikojmë me elektoratin, që ai të zgjedhë me vullnet të lirë kandidaturën dhe forcën politike që preferon!

Flitet se mund të ketë edhe kandidatura të tjera të pavarura që synojnë tek elektorati i PS-së dhe më gjerë. A ju rrezikojnë kandidatë të tillë?

Kandidatët e pavarur janë pjesë e procesit elektoral. Zgjedhjen dhe motivet për të kandiduar i dinë ata vetë. Unë nuk kam informacion për ndonjë të tillë, por ata që do të spekulojnë me elektoratin socialist, që do të përdorin emrin dhe siglën e PS, që do të shfrytëzojnë mllëfin, qejfmbetjen, apo gjithçka tjetër që kënaq egon e tyre, do të marrin përgjigjen e merituar politike dhe elektorale. Gjithsecili që e shikon veten të mënjanuar e të anashkaluar, jemi të hapur ta dëgjojmë, të bashkëpunojmë dhe ta integrojmë në hapësirat e pushtetit, nëse ka vlera dhe jep kontribute intelektuale e profesionale.

Cili do të jetë raporti midis financave dhe ideve në fushatën tuaj elektorale?

Do të përpiqemi që fushatës t' i japim natyrë festive dhe fjalimet, slloganet e mesazhet të jenë në një raport sa më normal me elektoratin, të luajnë rolin e tyre sensibilizues dhe të mos sjellin ngarkesa të larta politike. Ana financiare zë aq vend sa e parashikon ligji dhe kodi zgjedhor. Fjala është që kjo fushatë të japë modelin e zgjedhjeve të lira, demokratike, të pakontestueshme dhe të përcjellë te qytetarët atmosferën e një feste elektorale ku të kultivohet dashuria, solidariteti qytetar e mirëkuptimi. Njerëzit le të jenë bashkë. Ata le të ndahen për votën vetëm më 12 tetor 2003 dhe sërish të jenë bashkë!

Intervista: Me sekretarin e Degës së Partisë Demokratike të Re Berat, z. Simon Vrusho

Turqit kanë ikur dje, evropianët vijnë nesër?

* Deviza jonë: “Për një Berat evropian”.

*Konkurentët e tipit vegjegjativ, meskin dhe hedonist, konkurentët makutë, të cilët, me sa duket, nuk janë të paktë, paraqesin anën e mjerë të fushatës së kësaj vjeshte. Me një mungesë të frikshme vizioni për të ardhmen e komuniteteve, kjo skotë nuk e ka për gjë të bëjë fli nëpër orgjitë e saj interesat jetike qytetare.

* Në funksion të qeverisjes vendore ne jemi parti jopartiake.

Janë të rëndësishme zgjedhjet e 12 tetorit?

Absolutisht. Shumë të rëndësishme. Vota është i vetmi instrument me anë të të cilit qytetarët prodhojnë qeverisjen e vetvetes për vetveten. Nga mënyra e përdorimit të saj do të varet në se do të zgjidhen njerëz për të shërbyer, apo për të rrëmbyer. Problemet e grumbulluara janë të shumta. Përballë shembujve shkatërrues në qeverisjen vendore ne ofrojmë një mirëqeverisje me model moral, me ndjeshmëri dhe sens përgjegjësie. Nën devizën “Për një Berat evropian” fushata jonë, përveçse programore, do të jetë një apel moral, apel për vlerat humane. Kjo ngritje shpirtërore është e domosdoshme. Vatra të tëra të shoqërisë janë përfshirë nga kalbësia e korruptimit, duke iu falur fitim-përfitimit të paskrupullt si yll polar, kurse ai në të vërtetë nuk është

veçse syri i errët i humnerës.

Pse qytetari duhet të votojë për ju?

Qytetari është i lirë në zgjedhjen e tij. Ne ofrojmë idetë tona, vizionin tonë. Ne nuk jemi pretenciozë të dalldisur si ata që thonë: “Ne jemi më të shkëlqyerët. Ne jemi brilantët”. Apo : “Ne nuk jemi të përkryer, por jemi më të mirët”. Ne themi se jemi normalë dhe ofrojmë qeverisje normale. E dimë ç’do të thotë përgjegjësi dhe ndjenjë përgjegjësie. Ne themi me bindje se ka një Berat tjetër, një Berat të mirë, ka një Berat me dinjitet, është Berati i vërtetë, genuin dhe fin, fisnik dhe diskret. Është ai Berat që mund ta kthejë qytetin-muze në muzë për turistët, ku biznesmenët mund të konkurojnë edhe me krijimet shpirtërore të tyre. Është një Berat që ikën, por nuk duhet të ikë. Është një Berat që i ndryr energjitë, por që duhen çliruar. Duhet rindërtuar klima, kohezioni shoqëror. Partitë duhet ta gjallërojnë organizmin social, jo ta polarizojnë. Nga ky arsyetim vetëkuptohet se kujt zgjedhësi i drejtohem ne. Në funksion të qeverisjes si shërbim publik ne jemi parti jopartiake. Kjo na obligon të kërkojmë votën e qetë dhe jo votën e çakërdisur ulëritëse, sepse, e dimë shumë mirë, kjo e fundit prodhon qeverisje xhungle.

Si ju duket panorama e konkurrentëve të kësaj vjeshte?

Në peisazhin zgjedhor të 12 tetorit ... Për shkallën e njohjes që kam mund të them se ka edhe konkurrentë të tipit vegjetativ, meskin dhe hedonist, konkurrentë makutë, të cilët, me sa duket, nuk janë të paktë dhe këta paraqesin anën e mjerë të fushatës së kësaj vjeshte. Me një mungesë të frikshme vizioni për të ardhmen e komuniteteve, kjo skotë nuk e ka për gjë të bëjë fli nëpër orgjitë e saj interesat jetike qytetare.

Cili është pretendimi i partisë suaj në shifra konkrete?

Në organet qeverisëse vendore, si në Bashki e komunë ne synojmë një rezultat të ndjeshëm, shtrirje të përfaqësimit në të gjithë territorin, një mbështetje të listave të këshilltarëve tanë në masën mbi 10%. Jemi një parti në rritje e në ngjitje, pa zhurmë e bujë, por me hapa të vendosur, të matur dhe të palëkundur. Me që më pyetët për shifra, në garën për kryetarë të këtyre organeve ne hyjmë për të fituar, ndryshe nuk motivohet veprimi në këtë korsi.

Një pyetje të një numri tjetër, më personale. Ju i keni shlyer faturat e energjisë elektrike dhe të ujit çdo muaj?

Pyetje me vend. I kam shlyer rregullisht, pa asnjë rast kamatvonesë, edhe kur para katër vjetëve kam qenë dy vjet pa punë. Jeni të lirë ta verifikoni dhe, nëse nuk rezulton kështu, bëjeni publike në faqet e gazetës suaj.

Jeni mësues në shkollën 8-vjeçare të Kalasë. Si i përjetoni shqetësimet e banorëve të lagjes?

Diapazoni i pyetjes është i gjerë, por do të mjaftohem me shqetësimin e majit 1994 dhe dhjetorit 2002, kur dy herë është tentuar për ta mbyllur shkollën e Kalasë, pa arsye të qarta. Në të dyja rastet i jam bashkuar aktivisht reagimit protestues të banorëve, sikurse edhe kolegët, dhe e kemi mbrojtur këtë shkollë. Të paktën deri tani.

Tani, kur gjithë ata kandidatë e gjithë ato parti janë turrur drejt organeve të qeverisjes vendore, sa prej tyre do të jepnin dorëheqjen, kur ato që premtojnë nuk do të mund t’i realizonin dot? Është fjala për ata që do të fitojnë.

Vërtet, janë kaq shumë, sa që ky mund të quhet krosi masiv i vjeshtës. Jam skeptik për dorëheqjet që thoni ju. Ata sot qajnë për vota dhe, kur t’i ketë marrë, do t’u justifikohen se nuk kanë fonde duke u shtirë para qytetarëve me pamjen e qaramanëve. Këtyre, qytetari duhet t’u thotë që sot: Ç’fond aftësish ke që të sigurosh fondet për këto projekte që duhen realizuar?”

Sa i përket dorëheqjes them se është akt qytetar përballë rrethanash aqytetare, është akt i ndershëm përballë rrethanash të pandershme, akt moral përballë rrethanash amorale, akt normal në rrethana anormale. Kjo nuk do të thotë se po hoqe dorë nga një funksion, nga një pozicion, nga një detyrë, ke hequr dorë nga konceptet e tua, nga përgjegjësia qytetare e të hiqesh mënjandë. Konkurenca, koha të lënë mënjandë. Në demokraci nuk ka që të marrësh pushtet sot e të mendosh se nuk e lë më për 20-30 vjet, nuk e lëshon, nuk ta marrim dot etj. Jo. Ky mentalitet, i shprehur varfërisht shkurt, “nuk e lë, nuk e lëshoj, nuk e merr dot”, etj është shprehje mjerane e një logjike me frazeologji pengmarrësisë. Por shteti, pushteti, nuk mund të mbahen si pengje. Nga askush. Në demokraci, pushtetin mund ta marrësh me votë në mëngjes dhe po vota ta heq në darkë.

Si e përceptoni fushatën në Berat: të zbehtë, formale apo të vërtetë, reale?

Fushata nuk ka filluar. Jemi në prag. Të shohim. Por, pa debate, pa ballafaqime, pa përplasje argumentash, idesh, konceptesh, projektesh, vizionesh, pa dalë në shesh e vërteta e hidhur e keqeverisjes, fushata nuk do të kishte asnjë vlerë. Madje do të ishte tragjikisht e dëmshme. Të mbyllësh sytë, veshët dhe gojën përballë abuzimeve nuk është gabim apo faj, por krim. Sidoqoftë, tonin fushatës ia japin konkurentët për detyrat kryesore në bashki e komuna. Një gjë mund ta them me bindje: Mos prisni kandidatë cilësorë nga partitë kënetore. Nga strukturat e kënetave dalin kandidatë shushunjat.

Ju sikur keni një dozë idealizmi. Në fakt, realiteti është kaq i ashpër, kaq i vrazhdë?

Hm. Janë tri lloj këmbanash që bien: kambana e alarmit, kambana e pashkëve dhe kambana e vdekjes. Një pjesë e pakët ka përditë pashkë, u bie përditë kambanave të pashkëve. Pseja tjetër dëgjon kambanën e vdekjes. Janë ca të pakët që i bien kambanës së parë, të alarmit, se kështu nuk ecet. Kambana e parë zë vendin e parë. Kështu nuk ecet.

Cila është sfida me të cilat përballohet shoqëria sot?

Ka shumë sfida, njëra më e rëndë se tjetra. Janë një kompleks vështirësish që duhen kapërcyer. Problem i shtrirë në kohë që të ardhmen ta shohim si të ditur e jo si të panjohur është shndërrimi i mentalitetit në një shtrat solid vlerash humane me koncepte evropiane. Një gazetar në profesion të lirë, një gazetar hollandez, Robert Slagt, ndër më të famshmit në televizionet dhe gazetatat kombëtare të Hollandës, bëri një vizitë në Berat, në maj të këtij viti. Shprehu konsideratën e tij për vlerat e qytetit, për ndjenjat miqësore dhe potencialet shumë të mëdha që ai ka për t'u zhvilluar, për t'u bërë një atraksion turistik i vërtetë. Ndërkohë, duke kapur dhe defektet, ato u artikulluan në gojën e tij me shprehjen se këtu duket sikur turqit kanë ikur dje. Sigurisht, kjo shprehje, euforizëm apo metonimi, të fton të përsërisësh e t'i bësh ndonjë shtesë. Turqit kanë ikur dje, evropianët vijnë nesër?

Dhe evropianët jemi ne që duam të vemë në Evropë duke qëndruar këtu me dinjitet.

“Lajmëtari”

Të përndjekurit dhe arsyeja e mosarsyes së z. Nano

Titulli e justifikon përmbajtjen. Arsyeja subjektive e dashakeqe e z.Nano, e mban brenda kontraktitën e vetvetes dhe mosarsyen objektive të tij. Fillimisht, kur të burgosurit kërkuan dëmshpërblimin e viteve të burgut, z.Nano “u tremb nga shuma marra-mendëse” që duhej të paguante shteti shqiptar. I shkreti, sa e ruan lekun e shtetit! Atëherë ai tha: “Shuma disa miliardëshe do të na linte 10 vjet pa investime në arsim e shëndetësi”. Sikur të ndodhte vërtet kështu, çdo të thoshte populli i varfër, që dhe me këto “investime”, po heq pikën e zezë? Ai edhe njëherë, si i ati, hedh helm e vrer midis të burgosurve dhe popullit. Ama në thelb pranon që kjo shumë u takon të burgosurve por s'kemi ku i gjejmë. Kur protestat s'u ndalën, kamzhikët e gomës nxinë mishrat, shqelmat e policëve thyen brinjët e të burgosurve atëherë z.Nano tha: “Të burgosurve s'u takon se janë shpërblyer në kohën e Berishës.”

Thënia e dytë mohon të parën. Kjo është mosarsyeja që i bëhet arsyes të kulluar të z.Nano.

... Protestat vazhdonin ... Nanua ndihej ngushtë dhe i kërkon kadi Abdisë të interpretonte nenin 44. Ky i fundit, kadi i madh i Kushtetutës, melhemi i plagëve të Nanos, këtë herë s'e vuri dorën mbi plagë, s'kishte si bënte ndryshe i varfëri. Karvani i të burgosurve ecën për të arrirë sa më parë finishin e shumëpritur. Po Nanua? Ai urdhëron Gjykatën e Lartë dhe Institutin e të Përndjekurve të ndajnë shapin nga sheqeri, të burgosurit politikë nga ata ordinerë. Prapë paradoks. Çdo të thotë kjo? Shtyrje në kohë, asgjë më shumë. Zotërinj të nderuar, duke u ndodhur para një mëdyshje të tillë: “Ta jap, s'ta jap; të takon, s'të takon”, puna do menduar ndryshe. Fillimisht duhet të gjendet vullneti politik për dëmshpërblimin e të burgosurve, të vendoset kjo çështje në qeveri, të ligjërohet në parlament. Qofsha i gabuar, por një gjë e tillë s'ka ndodhur, pasandaj shikohen anët e tjera që do t'i quaja çështje teknike si:

a-Ndarja e të burgosurve në politikë dhe ordinerë, është e rëndësishme, por lehtësisht e realizueshme.

b-Kuota ditore e dëmshpërblimit.

c-Shtrirja në kohë e këtij të fundit, jo që s'janë të rëndësishme, por do të gjendet një vijë e mesme midis shoqatave dhe shtetit.

d-Cila kategori të burgosurish duhen likuiduar më parë e plotë të tjera si këto, por e para është ligjërimi në parlament.

Sipas bathëve, pashkët, o janë larg, o s'do të vijnë fare.

Protestat le të vazhdojnë, por protesta më e fuqishme, që s'kërkon mishra të nxira e brinjë të thyera, është vota kundër atyre që na mohojnë: mundin, djersën, gjakun e derdhur padrejtësisht, varret e humbura të bijve tanë.

Të jemi para kutive të votimit, krah për krah, si në protesta. Vetëm e djathta do të realizojë ëndrrën tonë!

Kryesia e shoqatës së të përndjekurve, dega Berat

Faleminderit, zoti KLINTON!

Në muajin shtator një delegacion i Ligës Shqiptaro-Amerikane do të vizitojë qytetin e Beratit

Dita e 19 qershorit 2003 do të mbetet e paharruar për ato dhjetëra shqiptarë të ardhur nga e gjithë Amerika kur, në zemrën e Nju- Jorkut gjigand, do të organizonin më të madhin takim në këto vitet e fundit për çështjen kombëtare, kryesisht problemin çam e atë kosovar. Ishte një takim, i cili do të kishte në ballin e nderit familjen e nderuar të ish -Presidentit Klinton. Vetëm para pak kohësh vetë zonja Hilari Klinton ngriti zërin për çështjen çame. E, ja ku vjen ky takim kaq i ngrohtë e i shumëpritur që të jep forca të punosh shumë më tepër për atdheun kudo ku të ndodhesh e në çfarëdo moshe që të jesh. Dhe u krijua atë ditë një mjedis sa zyrtar aq edhe familjar . Të gjithë flisnin për Shqipërinë, për ndihmën e Amerikës në zgjidhjen e çështjes shqiptare në vitet e fundit dhe dëgjonin plot respekt fjalët e zotit Klinton e të zonjës Klinton. Urime, falënderime, përgëzime miqsh e vëllezërisht të një ideali të madh siç është ai i vendosjes së drejtësisë në botë. Ishin në të, përfaqësues nga të gjithë shoqatat shqiptare që veprojnë në të gjithë Amerikën e që përbëjnë tashmë lobin e madh të shqiptarëve të Amerikës të organizuar aq mirë në Ligën Shqiptaro- Amerikane . Është një lob që po e thotë fjalën e vet jo vetëm në takime të tilla por edhe në sensibilizimin e problemeve në të gjithë organizmat evropiane e ato botërore. Përkrah tyre kishin në këtë tubim senatorët e shquar amerikanë të cilët e kanë lidhur tashmë veprimtarinë e tyre politike me problemin shqiptar. Është fjala për njerëzit e nderuar Bob Doll, senatorin Elion Engell, Xhozef Diguard etj.

Më tej nën hijen e dy flamujve që janë bërë pjesë e pandarë e jetës së çdo shqiptari në Amerikë atij amerikan e shqiptar në lokalit mikprites të atdhetarit të shquar Antoni Athanas, u organizua një darkë madhështore. Një grup artistik me valle e këngë të të gjitha trojeve shqiptare, fitues i disa çmimeve në SHBA e i drejtuar nga valltari i mirënjohur Bashkim Braho, e ndezi edhe më tepër darkën. Të tjera diskutime, tani në një mjedis më intim, vazhduan kontakte te tjera, plane te tjera. Një nga këto plane është një vizitë në disa qytete të rëndësishme të Shqipërisë në muajin shtator 2003, duke përfshirë edhe Beratin. Edhe Berati ka një komunitet të rëndësishëm në ShBA, në qytetet Nju Jork, Boston, Filadelfia, Çikago etj. Ashtu si ndodh në të tilla takime që njeriut i vijnë rrallë në jetë u bënë edhe disa fotografi kujtimi. Mes tyre veçuan atë që ish- Presidenti Klinton bëri me Ahmet Xhafën, një shqiptaro-amerikan, i cili ka shkuar në këtë vend që para 44 viteve. Buzëqeshje miqsh. Buzëqeshja karakteristike e Klintonit në këtë fotografi duket sikur të ngroh edhe më tepër për atë që do të vijë nesër. E bashkë me falende-rimimin e këtij “veterani” të çështjes çame në këtë vend të madh, bashkohemi edhe ne.

Faleminderit, Klinton! Faleminderit Amerikë! **Namik Selmani**

MEDIAKAFFE...

Në mbledhjen e fundit të Veteranëve të Luftës, do të zgjidhjet kryetari i organizatës-bazë, të veteranëve të një lagjeje. U propozuan dy kandidatura, Luli dhe Trimi. Luli u propozua si stërnip i njërit prej rrëmbyesve të shaptilografit aty nga gjysma e parë e shekullit të kaluar. Falë atij guximi të treguar nga stërgjyshi i takonte Lulit të drejtonte organizatën e Veteranëve të Luftës. Mirëpo Trimi, duke u prezantuar si kandidat, i la pa gojë Veteranët e pranishëm:

-Mendoj se më takon mua të jem kryetari i Veteranëve të Luftës. Luli është stërnip i njërit prej rrëmbyesve të shaptilografit. Mirë, por kam frikë se historia është ujdishur rrugës. Si ka mundësi që stërgjyshi i Lulit të rrëmbejë?

Për këngë e raki mejhaneve po, e besoj, por për rrëmbim?! Me siguri që ka qenë stërgjyshi im, a i vrrarë. Ne e kemi për fis atë punë. Tjetra dhe më kryesorja është se flitet për stërgjyshin e Lulit që paska vjedhur një makinë shkrimi në gjysmën e parë të shekullit të kaluar. Ta zemë se është e vërtetë. Pa i hidhni një sy ditëve tona, mor luftëtarë e stërnip luftëtarësh! A nuk mora pjesë unë në djegien e Bashksië, Gjykatës, Prokurorisë, Degës? A mund të krahasohet një shaptilograf a maqinë shkrimi me ato që i vodhëm ne regjimit të Berishës?! Mos doni të vëmë një pllakë aty në hyrje të qytetit ? Ja se ç’do të shkruaj: “Ky qytet u vodh, u dogj, u shkatërrua i tëri më 1997, duke u çliruar nga regjimi i Berishës”.

Po nga kush do të pyesni juve?

-Të gjithë duartrokitën fort Trimin. Nuk kishte nevojë më për votim. Ai u zgjodh kryetari i Vetëranëve të Luftës.

Një burrë i qetë, pasi kishte hedhur nja shtatë dopio raki sheqeri, u ngrit në mes të klubit dhe po bërtiste:

-Poshtë piramidat! Poshtë Sudja! Rroftë Farudin Arapi! Lavdi Komisionit Hetimor!

Kalimtarët ndalën këmbët dhe u drejtuan për në klub, po s’qe nevoja të futeshin brenda. Te dera u shfaq një burrë me shishen e rakisë në dorë. Pas e ndiqte kamarieri me masën e rakisë prej alumini.

-Doli piramidë! Poshtë Piramidat!

-Kushedi sa lekë ka humbur, i gjori,- po thoshte një kalimtare bjonde,- Këtyre burrave vetëm tek paratë iu rri mendja.
-Ik moj dreq, i foli një djalosh muskuloz,- s'guxon njeriu të pijë një gotë raki e të shfrejë një dert, se mbildhet tërë populli. Kur i thërret për miting s'të vjen asnjë.
-Por çfarë derti ka zotëria?- e ngacmoi sërish bjondja.
-Ka dert e det bashkë, moj vogëlushe. Ku nuk shkoi, kë nuk takoi, kujt nuk i telefonoi. Kaloi tërë ato votime, kaloi tërë ato prita, kaloi tërë ato sita. Dhe arriti në krye. Kur fap! Sa hap e mbyll sytë me një tërënë të kalemit u zgjodh kandidat një tjetër me urdhër nga lart dhe me duartrokite nga poshtë.
- Qe piramidë! Poshtë piramida! Poshtë Rrapush Xhaferri!- bërtiste ish-kandidati për kryetar bashkie.

Një bukinist po mblidhte firmat për të vendosur kandidaturën për kryetar bashkie, si i pavarur. Kur i hyn në librari një mik i tij, bukinisti i zgjat një listë të trashë për të shkruar emrin, mbiemrin dhe firmën, në mbështetje të kandidaturës së tij sipas ligjit. Miku i hodhi një sy listës për kuriozitet, para se të shkruante emrin dhe të firmoste.

- “Kush i ka mbetur ende mik, vallë?”-mendonte dhe hapi faqen e parë:

Homeri, Eskili, Dante Aligieri, Miguel Servantes, Uiliam Shekspir, Faik Konica, Gjergj Fishta, Migjeni, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Ylljet Aliçka.

-Ku do ta vendosësh kandidaturën?- e pyeti bukinistin, miku. Në Paris? Në Firence? Në Madrid? Në Londër? Në Shkodër apo në Tiranë? Me këta mbështetës që ke ti e ke të fituar kolltukun e kryetarit të Bashkisë në çdo qytet a kryeqytet të botës.

Bukinisti po e shikonte i habitur mikun e tij të vjetër.

-Po tallesh? -iu drejtua- Ndërsa unë e kam seriozisht.

-Jo nuk po tallem, por unë nuk jam në një sërë me këta të listës për të vënë firmën aty.

-Bjere, ore dreq, listën e inventarit të librarisë- iu drejtua kandidati dhe i zgjati listën e mbështetësve.

Ujërat e zeza pushtojnë shtratin e lumit Osum

Zyrat e Mbrojtjes së Mjedisit inegzistente

Ujërat e zeza dhe mbeturina të çfarëdoshme kanë kohë që pushtojnë lumin Osum, duke rrezikuar seriozisht shëndetin e banorëve që jetojnë përgjatë shtrirjes së tij. Gjithçka ka ardhur pas dëmtimit të kolektorit, që dikur përcillte ujërat e zeza për në zonën e kombinatit, ku bëhej përpunimi i tyre. Që prej 15 vjetësh ujërat e zeza të shumë lagjeve derdhen lirshëm në lumin Osum, duke përfshirë këtu dhe ujërat e zeza dhe mbeturinat e spitalit rajonal. Shëtitortja buzë lumit, ndonëse e ndotur krejtësisht prej erës së keqe, ku vazhdon të shërbejë për qytetarët si e vetmja mundësi për të kaluar orët e mbrëmjes, nuk mungojnë dhe mushkonjat. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se ekziston në qytet një zyrë për mbrojtjen e mjedisit, por se çfarë bën kjo zyrë askush nuk e di. Për të marrë një prononcim në këtë zyrë për problemin e ndotjes së lumit Osum, kemi trokitur shumë herë, por nuk kemi mundur të takojmë askënd. Banorët më të rinj të qytetit në krah të lagjes “30 - vjetori”, që janë vendosur këtu shkujdesur pas zgjerimit pa kriter të qytetit, janë ata që ndihen më të prekur nga ky problem. Ujërat e zeza të kësaj lagjeje dhe të lagjeve të tjera përfshirë dhe mbetjet e spitalit rajonal, kalojnë me anë të një kanali të zbuluar duke rrezikuar seriozisht jetën e banorëve që jetojnë në të. Burime nga Bashkia e këtij qyteti bëjnë të ditur se këtë problem do ta zgjidhte vetëm ndërtimi i një kolektori për të cilin ende nuk janë siguruar fondet e duhura.

Eriola Azizolli

Çfarë i mungon rrugës kryesore të lagjes “Muzaka

Me investimet e kryera kohët e fundit, rruga kryesore e lagjes “Muzaka” ka ndyshuar pamje. U hap kanali i ujit të pijshëm dhe u vendos tubacioni i ri, u hap kanali i mbuluar për ujërat e bardha, u asfaltua rruga, u shtruan për herë të parë trotualet, filluan të suvatohen dhe të lyhen fasadat e pallateve...

Megjithë këto ndryshme, diçka i mungon kësaj rruge kryesore. Dhe kjo që mungon është tepër e rëndësishme. Aq e rëndësishme, sa banorët e lagjes thonë, se ishim më mirë para këtyre rregullimeve. Zotërinj pushtetarë të bashkisë, merrni mundimin dhe kaloni një herë, një herë të vetme, anëve të kësaj rruge, aty pranë zgarave, veç të kini kujdes, mos harroni të keni me vete antigaze, ndyshe do të helmoheni nga një erë e keqe, mbytëse, helmuese, mikrobpërhapëse, që ndihet edhe nëpër dhomat e shtëpive, nëse i harron dritaret hapur. Dhe e gjithë kjo ka ndodhur se ndërtuesit, kanalën e ujërave të bardha, e kanë lidhur me kanalën e ujërave të zeza.

Mjedisi i ndotur nuk është vetëm në këtë rrugë. E morëm për shembull, se është një rrugë e re. Kudo nëpër Berat do ta ndeshim këtë gjendje dhe, ndoshta, edhe më të rëndë.

Siç duket ne nuk mund të shkojmë në Evropë pa parfumin e gjirizëve të Parisit.

Kjo më kujton një rrëfenjë që tregohej dikur në Berat:

“Një sulovar, që kishte zbritur në qytet për pazar, i bije rruga të kalojë pranë disa zonjave të parfumuara. Kur vete në shtëpi, i tregon së shoqes se zonjave të kasabasë u vinte fënda erë e mirë. Nuk e provon edhe ti një herë? Dhe kur gruaja e shkret me një barrë turp bëri ashtu siç i tha i shoqi, hëngri prej tij një dru të fortë. Mirë sulovari e nxori inatin te gruaja, po populli ku ta nxjerrë inatin e tij?...”

Agron Feriti

Të papunët beratas pas dy muajsh marrin përkrahjen sociale

Fillimi i kësaj jave ka nisur me shpërndarjen e ndihmës sociale për të papunët e këtij qyteti, që në dy muajt e fundit nuk e kishin fituar këtë të drejtë. Ndonëse jemi në javën e dytë të muajit gusht, burime nga zyra e ndihmës ekonomike pranë Bashkisë së qytetit, bëjnë të ditur se sapa ka përfunduar shpërndarja e ndihmës ekonomike për muajin qershor. Lëvrimi me vonesë i fondit nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ka bërë që vetëm pas dy muajsh të papunët të marrin ndihmën sociale. Sportelet e shpërndarjes së kësaj ndihme janë tejmbushur me qytetarë, që kanë mbajtur për orë të tëra radhë të gjata, për të marrë të ardhurat e pakta të kësaj ndihme. Dhe nuk janë pak, por rreth 3 600 familje në këtë qytet që jetojnë vetëm me të ardhurat e ndihmës sociale. Ditët e para të shpërndarjes së ndihmës ekonomike nuk kanë munguar dhe policët bashkiakë që kanë mbajtur nën kontroll procesin e punës të punonjësve të këtij sektori. Qytetarët nga ana e tyre shprehen për gazetën “Lajmëtari” se nuk është hera e parë që ndihma ekonomike shpërndahet me vonesë prej dy apo tre muajsh. Vështirësia ekonomike e tejskajshme ka shoqëruar prej dy muajsh këto familje në këtë qytet, me vonesën e sandakasë qeveritare.

Eriola Azizolli

Ndalet zemra e Mjeshtrit të Merituar Vangjel Melëngu

Javën e kaluar pas një sëmundje të rëndë u nda nga jeta pionieri i alpinizmit shqiptar, Mjeshtri i Merituar Vangjel Melëngu. Pa e mbushur moshën 16-vjeç, Vangjeli, së bashku me shokun e tij të lagjes dhe të punës, Petraq Kulen, hyn në rrugën e sporteve të alpinizmit, atletikës dhe të notit. Rruga e sportit nuk ishte një rastësi, por një dëshirë e pasion për t’u kalitur e argëtuar, një kënaqësi shpirtërore për të soditur natyrën e bukur e madhështore të vendit.

Kaluan vite me veprimtari të shumta dhe të hershme e bashkë me to rritej mjeshtëria alpinistike, rritej jehona dhe meritat, të cilat merrnin më shumë vlera.

Vangjeli ishte shkëndija e veprimtarive për pushtimin dhe emërimin e majave “Çuka partizani”, “Maja 11 shkurti”, “Maja e paqes”, “Maja e dritës”, “Maja 8 Marsi”. Disa prej tyre ai i ka drejtuar.

Ishte pjestar i grupit nismëtar të organizimit të aksionit të madh për në vendet historike dhe në pikat turistike të rrethit, veprimtari kjo tradicionale për Beratin, e cila u bë për gjithë vendin shembull burimi e frymëzimi. Vangjeli ka meritën që, së bashku me Mjeshttrin e Merituar Petraq Kulen formuan plejadën e artë të alpinizmit në Berat. Ai iu transmetoi brezave përvojën, mjeshtërinë, traditën duke i bërë alpinistët Vullnet Zyllyftari, Arqile Shyti, Jani Qendro, Toli Biçiku, Stefan Kule, Koçi Maqina, Kastriot Hoxha, të fitojnë tituj sportiv. Vangjeli si i zgjedhur në forumet shtetërore e vendore të sportit ka dhënë për vite me radhë ndihmesën e tij për ecurinë e alpinizmit shqiptar.

Me shumë se një gjysmëshekull Vangjeli ka marrë pjesë në shumë ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë, verore e dimërore, dhe në ekspeditat ndërkombëtare të viteve 1961 në Alpe, 1962 në Korab, 1963 në Lurë, me pjesëmarrjen e alpinistëve çekë, sllovakë, gjermanë, polakë. Ata janë befasuar me forcën, guximin, optimizmin e Vangjelit duke e quajtur “Perla e alpinizmit shqiptar”, “Buldozieri i dëborës”. Vangjeli, mbi të gjitha, ishte njeri me botë të madhe, i thjeshtë e bujar, i besës dhe tolerant, njeri i këngës dhe i humorit të këndshëm sportiv, që i jepte lezet veprimtarisë.

Zemra e mjeshtrit këto ditë u ndal. Ai u la brezave kujtime dhe mbresa të punës dhe të veprimtarisë së tij me shumë se gjysmëshekullore, dhe Beratit i dha emër dhe krenari.

Vullnet Zyllyftari, Nikollaq Mata, Ismet Ajazi, Vangjel Shkurti, Arqile Shyti, Jani Qendro, Stefan Kule, Koçi Maqina, Kastriot Hoxha, Vlash Pambuku.

Kastriot Dervishi

Hasan Nallbani

Lideri shpirtëror i artistëve të penelit beratas

Takimi me piktorin

U desh një kafe e rastësishme me një shokun tim të fëmijërisë dhe një kujtim i një detaji të shkurtër të jetës sonë, të hedh këto rreshta për mikun tim,

**Piktorin e Merituar, Doktor Profesor
Hasan Nallbani.**

Vitet 70

“Kam zbuluar një vend ku ka ngjyra dhe penela, është një shtëpi e vjetër, afër lodrave të lagjes sonë (te sarajet në Muratçelepias), - më thotë miku im Arturi, dhe shkojmë së bashku ku morëm disa tubeta dhe penela të vjetra. Piktori është transferuar në Tiranë dhe nuk vjen më në Berat dhe këto (hedhurina) na përkasin neve”.

Nuk mund t'i përshkruaj emocionet e mia kur për herë të parë në jetën time preka materiale artistësh. Mbase ky ka qenë edhe motivi që jetoj brenda meje kaq gjatë, ky kujtim nga një lojë e fëmijërisë, e cila ka qenë e përcaktuar nga dëshirat, madje nga një dëshirë e vetme, e cila ndihmoi edukimin tim, dëshira për të qenë i rritur, dëshira për të imituar të rriturit dhe në rastin konkret të vendosur në kohën e shkuar të viteve 70, mikun tim të panjohur, artistin Hasan Nallbani.

Kush është Hasan Nallbani?

Lindi më 15 maj 1934, në lagjen Muratçelepias, nga një familje qytetare beratase, i biri i Mustafait dhe i Feties. Filloren e kreu në shkollën “24 Maji”. Në vitin 1949 filloi studimet në liceun “Jordan Misja” në Tiranë, që e përfundoi në vitin 1954 vit i cili për artistin është një nga pikat më të rëndësishme të jetës së tij, pasi shënon dhe ekspozimin e tij të parë në një Ekspozitë Kombëtare në Tiranë me 18 piktura nga qyteti i Beratit.

Ekspozim i cili nuk është ndërprerë për një gjysmë shekulli.

Në vitin 1959 hapet për herë të parë Instituti i Lartë i Arteve, ku Nallbani fillon studimet dhe i mbaron në vitin 1964. Pas përfundimeve të studimeve të larta kthehet në vendlindje, ku fillon të udhëheqë me punën e tij artistët figurativë të Beratit. Afro 7-8 vjet pune në Berat fiton disa çmime të para në ekspozitat e organizuara. Por gjatë kësaj kohe punon njëkohësisht dhe si specialist në Monumentet e Kulturës.

Në vitet '70 fillon punë në Tiranë si profesor në Akademinë e Arteve dhe njëkohësisht punon në Institutin e Monumenteve të Kulturës. Pas një pjesëmarrjeje të suksesshme në të gjitha ekspozitat kombëtare dhe ndërkombëtare që duket dhe në vlerësimet që ka marrë:

1970 medalje “Naim Frashëri”, 1980 piktura “kooperativistet” shpallet piktura më e mirë e vitit në Shqipëri, 1982 çmim të parë kombëtar, 1984 çmimi i dytë kombëtar, 1984-1986-1988 merr pjesë në Bienalet e Aleksandrisë dhe të Ankarasë, në 1984 hap ekspozitën vetjake në Tiranë, 1972-1994 punon si profesor pikturë në Akademinë e Artit dhe për rrjedhojë **në vitin 1986 i jepet titulli “Piktor i Merituar”.** Po kjo është vetëm njëra anë e medaljes së tij, e cila e rrjeshton në Elitën e artit shqiptar. Ana tjetër është ndihmesa e tij që ka dhënë në fushën e monumenteve në Shqipëri.

Monumentet e Artit Shqiptar në duart e Hasan Nallbanit

Duke filluar që nga viti 1970 jep kontribut të madh në fushën e monumenteve që vazhdon pa ndërprerë deri sot, për 35 vjet, duke qenë protagonist kryesor i studimeve shkencore si dhe duke ndërhyrë në të gjitha monumentet e Shqipërisë. Ia vlen të përmendim disa nga pikat kulmore në këtë fushë.

Në vitet 1970 bëhet anëtar i redaksisë të revistës “Monumente” dhe në vitin 1973 autor i albumit “Monumente të Arkitekturës dhe të Arteve në Shqipëri”. Në 1987-ën është bashkautor i “Historia e Artit Botëror” dhe “Teoria e Arteve Figurative”, botime të Universitetit të Tiranës. Studimet e tij fillojnë me Onufrin, David Selenicën, Xhaminë e Beqarëve në Berat, mozaikun e amfiteatrit të Durrësit, artin bizantin në qytetin e Beratit, mozaikun e baptisterit në Butrint, restaurimin e të gjitha ikonave në Shqipëri, për pikturën e Kishës së Shën Mërisë në manastirin e Apollonisë, për mjeshtrat e arkitekturës popullore, për pikturën murale bizantine në Shqipëri, prezanton albumin për muzeun Onufri në Berat si dhe disa zëra për “Fjalorin Enciklopedik” të Aka-demisë së Shkencave dhe për enciklopedinë italiane “treccani”. Pra këto janë pak nga studimet e tij duke përfshirë dhe shumë kumtesa që ka mbajtur brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ai ka bërë ndërhyrje në punime konservimi në Kishën e Shën Triadhës dhe Kostadinit dhe Helenës në Berat. Me qindra ikona kanë kaluar në duart e tij për muzeumet kombëtare Onufri në Berat, Korçë e Tiranë si dhe ndërhyrjet në pikturat murale në Mborje, Boboshticë, Maligrad, në Shënkoll, Shën Mëri, dhe Shën Mëhill në Voskopojë, në Shën Mërinë e Apollonisë, në mozaikët e Durrësit e të Butrintit. Pra, siç duket, ka ndërhyrë me duart e tij në perlat e Shqipërisë dhe kjo punë ka bërë që të drejtojë nga 1987 e më pas komisionit e kualifimit pasuniversitar si dhe sektorin e Artit në Institutin e Monumenteve në Tiranë.

Të gjitha këto kanë sjellë titujt e lartë:
në 1990 Doktor i Shkencave historike,
në 1995 i jepet titulli Profesor
dhe aktualisht ka fituar pension për merita të veçanta.

Thelbi i artit të tij

Në krijimtarinë artistike shqiptare, është sinonim i pjekurisë krijuese. Po ta ngushtojmë rrethin dhe ta vendosim në kuadrin lokal, pa dyshim ai është lideri shpirtëror i artistëve të penelit beratas, ai identifikohet për autenticitetin dhe thellësinë artistike si dhe vlerat shpirtërore, por edhe pohim i historisë së re të arteve vizive të Beratit dhe artit shqiptar në tërësi, përfaqësues i elitës së artit shqiptar.

Artisti dhe vendlindja

Pa ndërprerje ka marrë pjesë në qytetin e Beratit në të gjitha organizimet artistike dhe shkencore, saqë mund të thuhet se ka qenë qytetar i Beratit (dhe është) dhe se shumë mund të dinë se jeton akoma në Berat, pasi nuk ka munguar asnjëherë. Një pikë të rëndësishme në vlerat e tij zënë dhe veprat nga qyteti i Beratit. Nuk ka kënd pa pikturuar dhe pa prekur me penel nga ky qytet. Hasan Nallbani hyn te personalitet shumë të larta të artit shqiptar dhe, në veçanti, mund të quhet themeluesi i pikturës laike në Berat dhe konservuesi më i shkëlqyer i monumenteve të artit në Shqipëri.

Plagët e shpirtit

Në kujtim të vëllait tim

Syrja Beratit

Syrja Berati u lind më 12 prill 1925. Ka kryer Institutin e Agronomisë “Nicolo Seraffini” në Fabriano në Itali. Në dhjetor 1944 emërohet agronom, pastaj në janar zv/ kryeagronom i qarkut të Tiranës. Në vitin 1949, kur kryente shërbimin ushtarak në Pogradec, arrestohet dhe nën akuzën e sajuar “agjitacion e propagandë në radhët e ushtrisë”, dënohet me vdekje. Dënimi iu kthye në 20 vjet burg, nga të cilët e vuajti 7 vjet. Pasi doli nga burgu, u emërua agronom në kom. ekzekutiv të Beratit. I dashuruar pas profesionit, ka punuar me pasion kudo që është emëruar: në Kooperativën e tipit të lartë në Lapardha, në drejtorinë e farnave, në kooperativën Fushë -Peshtan dhe në Starovë, ku doli në pension në vitin 1987. Vdiq në 18 mars 1989.

Thonë se koha është mjeku më i mirë për shërimin e plagëve.

Sigurisht ka ngjarje që, me kalimin e kohës, i mbulon pluhuri i harresës. Por koha nuk mund të shërojë gjithçka. Ashtu si nuk mund të harrohet plaga e plumbit, që ka mbetur pa u hequr nga trupi i viktimës, ashtu nuk mund të kalojnë në harresë plagët e shpirtit. Kur në momente të caktuara këto plagë ngacmohen, ato çahen, zgjerohen dhe prej tyre kullon gjak i pastër, gjak shpirti të plagosur. Plagët e shpirtit janë nga më të dhimbshmet e nuk harrohen kurrë dhe kur këto ngacmohen e fillojnë të rrjedhin, sa e sa kujtime përjeton dhimbshëm ky shpirt i plagosur.

Për plagën që mori shpirti im në marsin e 1989-ës, kur ti, vëllai im Syrja, u largove përgjithmonë nga sytë tanë, dua t’i shkruaj këto radhë.

Do t’i lutesha mrekullisë që ti, si një ëngjëll të çoheshe nga varri, të shikoje, ende të stamposur përjetësisht në sytë e mi, dhimbjen e madhe që unë provoja kur ti në grahmat e fundit më thërrisje: “Fatmir, Fatmir ... po mbaroj” dhe dhimbja ime rritej e rritej se unë isha i pafuqishëm të përballës me atë fuqi që askush s’mund të përballohet e që quhet vdekje. Do të desha që në këto çaste ti, o vëlla i paharruar, të bëheshe veshi im dhe të dëgjoje edhe sot si atëherë, si gjëmimi pas rrufesë, jehonën e thirrmeve të tua “Fatmir, Fatmir, ...” Jam i sigurt se ato thirrma qenë për mua jo pak të dhimbshme se sa për shpirtin tënd dyfjalësh: “Dënim me vdekje”, i deklaruar nga Kryetari i Gjykatës Ushtarake më 1949-ën në Pogradec, kur ti kryeje shërbimin ushtarak. Do të doja të dëgjoja shprehjen tënde “akoma nuk është kthyer Fatmiri?...”, drejtuar Cikut dhe Manushaqes, atë natë të 15 marsit 1989, kur unë në orën 10 të natës, u nisa nga spitali në shtëpi, për të marrë trinitrinat se spitalit i mungonin. Do të doja të futeshe në shpirtin tim dhe të provoje vuajtjet, që unë vëllai yt 60-vjeçar provoja, se nuk mund të bëhesha vetëtimë dhe, sa hap e mbyll sytë, të veja e të kthehesha nga shtëpia me trinitrinat, që ne atëherë kujtonim se me to do të bëhej mrekullia. Çdo minutë, gjatë rrugës për në

spital, mbartte në shpirtin tim, të koncentruar ankthin e çdo 24-orëshi që provoje ti në pritje të skuadrës së pushkatarëve që do të zbatonin vendimin e gjykatës ushtarake dhe ashtu si ti, përveç ankthit të ekzekutimit të pritshëm, përballeshe me asfiksion që dielli përvëlues duke rënë mbi çadrën-burg të repartit ushtarak të zinte frymën, ashtu dhe unë duke nxituar nuk mbushesha dot me frymë, më priteshin gjunjët dhe herë ngrihesha, herë hiqesha zvarrë vetëm e vetëm që të arrija në kohë dhe të mos më shkonte kot ai stërmundim. Në ato minuta, sa një shekull, kujtoja vuajtjet shpirtërore të prindërve tanë dhe përpjekjet shumë të vlefshme e me shume mjeshtëri të tyre, që e ndryshuan vendimin e Gjykatës të 1949-ës nga “dënim me vdekje” në “dënim me 20 vjet burg”.

Po nëse në 1949-ën ata fituan mbi vdekjen 40 vjet të tjera unë munda të fitoj vetëm 48-orë në 1989-ën.

Më fal vëlla por në këtë rast unë isha fajtor pa faj. Edhe ti ishe fajtor pa faj që pasojat e dënimit tënd na ndoqën jo vetëm për sa kohë ti jetove pas burgut, por edhe më pas.

Në të gjithë ishim viktimë të origjinës sonë prindërore, me të cilën ishim krenarë dhe krenohemi, por që e paguam shtrenjtë dhe, veçanërisht, drejtëpër-drejtë, më shumë se të gjithë ne, e pagove ti me vitet e burgut, me punë të detyruar nëpër kampet, me izolimet në birucat e burgjeve, me luftën psikologjike, me torturat nga më mizoret, të cilat askush nuk mund t'i përfytyrojë, as t'i imagjinojë, me atë barbarizëm si i provove ti, or vëlla i paharruar, dhe bashkëvuajtësit e tu.

Çdo shkrim e përshkrim, qoftë dhe nga pena e një shkrimtari të madh, çdo tablo e piktorit më të shquar, që do të rrekej të pasqyroje vuajtjet e torturat tuaja, do të ishte një kopje e zbetë e atij ferri. As Ferri i Dantes nuk i afrohej Ferrit të komunizmit shqiptar. Vetëm mendja diabolike e komunizmit Enveristo-Stalinist mund të propagandonte dhe të arrinte të hymnizonte diktaturën mbi demo-kracinë, moralin komunist mbi moralin fetar, injorancën mbi kulturën, tradhëtinë mbi besën, mashtrimin mbi të vërtetën, urrejtjen mbi dashurinë, luftën mbi paqen.

Luftë ndërmjet klasave të shoqërisë, luftë në kolektiv, luftë në gjirin e partisë, luftë brenda familjes, luftë, luftë, ... kudo luftë. Mbeturinat e këtyre mendësive po i përballim edhe sot e kësaj dite, me forma tepër të sofistikuar.

Ti u largove para kohe dhe nuk arrite të shihje se si kameleonët brenda një nate zhveshën lëkurën e tigrin dhe veshën atë të qengjit. Ti ike parakohe dhe nuk përjetove hemoragjinë e popullit tonë kur shumica e tyre të rinj, për të shpëtuar nga ferri komunist, ikën e ikën, nga sytë këmbët, përtej detit në kërkim të një jete më të mirë. Dhe hemoragjia prej më shumë se 10 vjetësh vazhdon. Shoqëria po plaket, po boshatiset dhe gomonet në Adriatik, në garë me njëra-tjetrën, përtërijnë tragjedinë e “Titanikut” pa i dalë kush për zot që ta ndalojë. Ti ike para kohe dhe nuk arrite të shihje se si “hajdutët e pulave” që u liruan nga burgjet, të dënuar me akuzën e rreme “për agjitacion e propagandë”, u vërsulën si lukuni, për të rrëmbyer sa të mundnin e çfarë të mundnin dhe ku të mundnin, kurse pjesa më dinjitoze e bashkë-vuajtësve të tu, të mashtruar sipas një skenari të projektuar përsëri në kulisat e sistemit komunist, së bashku me një pjesë të zgjedhur të militantëve të “Nënë-parti”, u grumbu-lluan njëherësh për të “përmbysur komunizmin” dhe pastaj u shpërndanë sa në një parti, në tjetrën.

Ti ike parakohe dhe nuk arrite të shihje se si në shoqërinë shqiptare u prishën ekuilibret, ekuilibret ndërmjet klasave, ekuilibret ndërmjet shtre-save të ndryshme brenda të së njëjtës klasë, ekuilibret ndërmjet fiseve, ekuilibret brenda të njëjtit fis, deri në prishjen e ekuilibrit brenda të njëjtës familje, të cilën po e jetojnë edhe sot sa e sa familje të nderuara. Ti ike parakohe dhe nuk përjetove fillimin e procesit të kthimit të pronës, gjatë të cilit instikti foshnjarak që “çdo gjë është imja” shpërtheu si një fontanë zifti nga skutat më të errëta të genies njerëzore.

Kështu filloi tronditja e projektuar, që prishi dhe vazhdon të prishë deri në shkatërrimin e plotë të këtyre ekuilibreve. Dhe strategjia e sekanrit diskriminues ende vazhdon. Ti ike para kohe dhe paske qenë i dashuri i Perëndisë që nuk përjetove provën më të vështirë, dramën më të dhimbshme të njeriut të ndershëm, degradimin moral të çdo qelize të shoqërisë, veçanërisht degjenerimin e femrës shqiptare. Ne ende nuk po gjejmë forca, as mënyra për ta përballuar këtë tragjedi shoqërore dhe familjare. Ne ende nuk po mund të shpëtojmë nga ky batak ku na kanë futur e që mundohet të na përpijë dhe të stigmatizojë me njollën e trupit vlerat më fisnike të prejardhjes sonë.

Zoti na dhëntë shëndet, durim, vullnet e guxim për të përballuar me dinjitet këtë tragjedi! Dalçim faqebardhë e fitimtarë!

Zoti na sjellë një Herkul që të spastrojë këto stalla të Ozhias!

Avgjia (Ozhias):

Mbret i Elidës, Peloponez. Herkuli pastroi hauret e tij duke kaluar nëpër to rrjedhën e lumit Alphe (Alfe).

Falënderim

U nda nga jeta më 9 gusht 2003, Manushaqja, bashkëshortja e Syrja Beratit, duke lënë në pikëllim djalin, familjen e tij, familjarët e farefisin.

Do ta kujtojnë me respekt ish-nxënësit e saj të shkollës ushtrimore pranë pedagogjikes së Elbasanit, nxënësit e shkollës së Otlakut në Berat, kolegët e saj të arsimit si një mësuese të talentuar.

Do ta kujtojnë me respekt banorët e lagjes si një nënë të devotshme që rriti, edukoi e shkolloi me sakrificat më madhore djalin e saj, Arensin, avokatin e ri, që përtëriu traditën e familjes.

Me këtë rast falënderojmë komshinjtë dhe shokët e ngushtë të Arensit për solidaritetin human të admirueshëm, për gatishmërinë në marrjen e detyrave të rastit qysh në minutat e para të fatkeqësisë.

Falënderojmë gjithashtu farefisin, të afërmit, dashamirët e shoqërinë, që me pjesëmarrjen e tyre në ceremoninë mortore na lehtësuan sadopak dhimbjen.

Në gëzime ua shpërblefshim!

Nga familja Berati

Ajet Nallbani

Ahmet Kurt Pasha sundimtari dhe arkitekti

Berati ka patur njerëz të ndritur, që kanë lënë emër në histori. I tillë ishte edhe Ahmet Kurt Pasha, sundimtari i pashallëkut të Beratit.

Rridhte nga një familje feudale nga fshati Ngurrëz. Flitet se zbriste nga dyert e larta të kalifëve të Mekës. (Sipas Eqrem bej Vlorës vinte nga Prizreni.)

Gojëdhënat na thonë se është rritur jetim në shtëpinë e Ismail Pashë Velabishtit.

Nga martesë me të motrën e Ismail Pashës pati dy fëmijë, Mehmetin dhe Merjemen. Kjo e martuar më pas me Ali Pashë Tepelenën.

Më 1764 Ahmet Kurti emërohet nga Porta e Lartë në sanxhakun e Vlorës dhe më vonë vezir, duke iu besuar detyra e derven pashës së Epirit dhe të Moresë. Me qendër në Berat, mbante nën kontroll gjithë rrugët e Shqipërisë së Jugut dhe të Epirit deri në grykën e Termopileve mbi Athinë.

Pushteti i tij në pashallëk ishte i plotë. Por pashai i zgjuar dinte të bënte pas vetes njerëz që kishin influencë në qytet dhe rreth tij. Ai mbante marrëdhënie të ngrohta me esnafet e Beratit.

Ahmet Kurti bëri shumë punime ndërtimore në Berat, duke i plotësuar fiziominë e një qyteti kryeqendër të Shqipërisë.

Në vitin 1782 rindërtoi Teqenë e Helvetinjve mbas dëmtimeve të pësuar Ky ndërtim përfaqëson kohën e ndryshimeve të bëra në arkitekturën e kësaj ndërtese, me elemente dhe veçori të arkitekturës shqiptare.

Në kohën e tij u ndërtuan një mori dyqanesh në qendër të qytetit, si dhe bezistenit, që siguronte hapësirën më të madhe të tregtisë.

Në veprat e shkruara për këtë kohë, Berati përmendet si qytet i madh me ekonomi të lulëzuar, me objekte me arkitekturë të veçantë dhe me një kulturë që e cilësonte si kryeqendër.

Madhështia e Kurtit nuk qëndron vetëm në faktin se ai ishte një njeri i zhvillimit, që ndërtoi vepra madhore si Urën e Goricës, pazare, ujësjellës, xhami, teqe, por edhe se ruajti dhe rikonstrukttoi vepra të trashëguara nga të parët. Ai i bëri rikonstruktion edhe të Kalasë.

Ura që lidhte Goricën me anën tjetër të qytetit, ishte prej druri. Ajo rrezikohej shpesh nga vërshimi i lumit. Kurti ndërtoi një urë të re, me harqe guri, mjaft të fortë dhe të bukur, që i ka rezistuar çdo prurjeje të lumit. Gojëdhënat na thonë se murimi në këtë urë është një dukuri e veçantë, që i largohet legjendave të hershme. Në njërin nga shpatullat e urës u muros një nuse e gdhendur në dru.

Nga të dhëna gojore mësojmë se kur Kurt Pasha vendosi të ndërtonte Urën e Goricës të gurtë, thirri ustabashin, i cili, mbasi e dëgjoji dëshirën e pashait, duke menduar se me të nuk mund të bënte dot pazarin e duhur, i thotë se ky ndërtim nuk mund të bëhej, sepse lumi kishte shumë ujë. Pashai, i zgjuar, nxori një qese me flotinjtë dhe e hodhi në lumë. Ustabashi ktheu mendje dhe mori përsipër ndërtimin e urës.

Në një gojëdhënë tjetër thuhet se pashai i dha kapar një ustai për forcimin e kullave të Kalasë, duke i vënë si kusht se ai, në mbarim të punës, do t'i provonte me top. Nëse nuk do të rezistonin, përgjegjësia do të binte mbi të.

Pas marrjes së kaparit, ustai u largua dhe nuk u duk për shumë vjet. Pashai i inatosur, vuri njerëz, që, pasi e gjetën, ia sollën të lidhur.

“E di ç’ të pret tani?”, i thotë i egërsuar pashai.

“Pse?”, i përgjigjet ustai.

“Për punën që more përsipër dhe nuk e bëre, por u fsheve dhe paratë i përvetësove.”

“Jo, madhëri,- i thotë ustai,- paratë i ke pranë kullave të groposura.”

Dhe i tregoi pashait gëlqeren që kishte blerë dhe e kishte groposur për t’u vjetëruar.

“Tani, pasha, ka ardhur koha për të filluar nga puna.”

Mbasi mbaroi punën, ustai i thotë pashait: “Tani mund të zbrazësh topin e provës dhe mua të më japësh hakën që kërkon djersa e ballit.”

Më 27 qershor 1778, sipas Kostë Beratit, nga shiu dhe breshëri i madh u mbytën dyqanet e qytetit nga prurjet e përrrenjve. Mendohet se kjo fatkeqësi natyrore shënon dhe datën e ndërtimit të galerive të nëndheshme me qemere guri që përshkojnë qendrën e qytetit për të disiplinuar këto prurje. Në këtë kohë, flitet në kronikën e mësipërme, u mboll edhe kurora në kodrat veriore të qytetit me vreshta të shumta.

Ky ishte i fundit pasha që la vepra dhe emër në historinë e Beratit dhe të Shqipërisë.

Nga një kronikë e Kostandin Beratit

Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XVIII vendi u pushtua nga anarkia feudale. Feudalët shqiptarë, duke përfituar nga dobësia e pushtetit qendror osman, u angazhuan në luftëra të gjata kundër njëri-tjetrit për të zgjeruar kufijt e pashallëqeve të tyre.

Në vitin 1775 Mustafa Pashë Shkodrani u nis kundër Ahmet Kurt Pashës me 10000 ushtarë për të pushtuar Beratin.

Këtë ngjarje e gjejmë edhe në një kronikë të Kostandin Beratit:

“I famshmi Karamahmut Pashë Bushatlliu sulmoi me forca të mëdha Beratin nga ana e Sulovës. Një frikë e madhe pushtoi qytetin. Me shpejtësi u armatosën gjithë rufetllinjët (esnafet) e qytetit, ngritën shatoret në kodrat me ullinj të Biftës, Gërricës dhe të Shën Thanasit. U rreshtuan për luftë në atë mënyrë që i lanë Bushatlliut vetëm dy gryka të rrezkshme kalimi, atë të Vronit dhe atë të Duhanasit, me qëllim që t’i gënjenin dhe t’i fusnin në pusi forcat armike. Forca të mëdha ushtarake të Kurt Pashës rrinin në pritje.

Në ndihmë të qytetit u bashkuan fshatarët e nahijes së Beratit. Esnafet qëndruan në pozicione për 22 ditë. Karamahmuti e kuptoi grackën e përgatitur dhe i ngriti çadrat e mori rrugën e kthimit për në Shkodër, duke kaluar nga Peqini. Pashai i Beratit u vu në ndjekje. Në një luftim që u bë rreth kalasë së Peqinit Bushatlliu sa s’u zu rob.

Fitores populli i këndoi këngë, që fillonte me vargun “Aferim, djemtë e terzihanës!...”

Ali Tepelena rob përpara Ahmet Kurt Pashës

Pashit të plotfuqishëm i sollli mjaft shqetësime banda e Aliut me grabitjet e karvaneve. Kurt Pasha organizoi gjithë bejlerët për kapjen e tij. Por banditi finok nuk binte kollaj në grackë.

Një ditë, Aliu me gjashtë banditë të tjerë, u gjend në sheshin e kalasë së Beratit me znxhirë në qafë.

Shtatë trekëmbësh u ngritën për t’u marrë jetën shtatë banditëve, që ia kishin nxirë jetën pashallëkut dhe pashait.

Aliu njëzetvjeçar, i fuqishëm dhe i fortë, dinak dhe i matur në përgjigje, i shpëtoi litarit.

Siç tregon historia, ishte bujaria, zgjuarsia, shpirtgjerësia e Kurt Pashës, ndryshe nuk do të kishte Ali Pasha me historinë e tij, nuk do të kishte diplomaci të Ali Pashës, nuk do të kishte një kundërshtar të egër një perandori e madhe, nuk do të kishte një kokë të prerë që shetiti gjithë perandorinë sa arriti në kamaren e turpit, nuk do të shkruante historia për njeriun me dy varre.

Ishte këshilltari i Kurt Pashës që i tha pashait që ky njeri duhej të ruhej si dorë e sigurtë për fatet e pashallëkut të Beratit.

POETË BERATAS NË SHEKUJ

6.

SULEJMAN TEMANI

Shek. XVIII-XIX

Poet mistik.

Jetoi në kufijtë e shekujve XVIII-XIX. Ishte sheh helveti dhe poet. Krijimtaria nuk i njihet e plotë. Disa poezi ia botoi **Abdullah Ferhati** në revistat “Zani i naltë” dhe “Kultura islame”. Trajtoi temat fetare.

NJË DIT' SAHATI MË NËNTË

Një dit' sahati më nëntë,
më ra një zjarr në zemër,
afër m'u prishën mënt,
ani mbeç pa fiqir.

Si bilbili po bëj figan, 1)
nga syt' më rrjedh gjak
prej ashkut tënd, o sulltan!
A s'më bën derman, ja Hak? 2)

Un' talib e ti matlub 3)
e për ty fakiri po qan,
me derte, si hazreti Jakub
për Jusufin në Qenan. 4)

Un' zerre e ti gjynesh, 5)
më nurt jam bër' hajran; 6)
në zemër ashkun tënd ta kesh,
të digjem për ty, o sulltan!

1. **Figan: qarje.**
2. **Hak: i vërtetë, emër i lartë i Zotit.**
3. **Talib: kërkues.**
Matlub: kërkesë.
4. **Qenan: Pelestinë.**
5. **Zerre: Grimcë**
6. **Gjynesh: diell.**
7. **Hajran: i habitur.**

7.

OMER SADEDINI Shek. XVIII-XIX

Poet beratas me krijimtari të pazbuluar. **Robert Elsie** e njeh poet nga Shqipëria e Jugut. Bën të ditura prej tij dy poezi, që nuk na i jep. 1) **Vexhi Buharaja** e njeh poet beratas me mbiemrin **Nadini**. E përmend të tretin pas **Nezimit** dhe **Sulejman Nai-bit**.

1. **Robert Elsie, “Histori e letërsisë shqiptare”, 1997, faqe 83.**
2. **Vexhi Buharaja, “Islam Vrioni ndërroi jetë”, në “Kultura islame”, 1941, nr. 23-24.**

Të kam puthur këmb' e gjunjë,
un' prej teje jam hushnut, 1)
ti të ma këndoç jasinë, 2)
kur të më vënë në tabut.

Jelek kadife veshurë,
përsipër abidi shalli, 3)
më vjen me buzën duke qeshurë,
qesh i vdekur me gjallni.

U nis sheh Sadedini për Qabe, 4)
Allahu ia pruftë mbarë.
Kur të nisesh, të më dëftenc,
të të përcjell duke qarë!

Udha e Qabesë, edhe pse për poetin është fatndjellëse dhe një detyrë e çdo myslimani që i përmbush detyrimet ekonomike, për kushtet e vështira të udhëtimit, ajo mbart edhe dhimbjen e ndarjes nga njerëzit e dashur. Poeti, nëse mendohet se nuk do t'i përballojë vështirësitë e udhëtimit, e ndien sërish veten të kënaqur se, kur ta shtrijnë në tabut, të paktën do t'i këndohet një jasin. Por, këtij shqetësimi, ai i kundërvë bindndjen: i vdekur nuk ka për të qenë, ashtu siç u duket nga merak, prandaj ata t'i mbledhin mendt se ndërgegjen e tij të thellë s'kanë ku e gjejnë. Poezia shquhet për lirizmin e saj. Ajo na kumton bindjern e thellë të poetit tek Allahu. Është një nga këngët beratase më të kënduara.

1. Hushnut: kënaqur.
2. Jasin: emër i një kreu të Kuranit.
3. Abidi shalli: shall i një besimtar të thjeshtë.
4. Sipas traditës, këtu kemi emrin e vet autorit.

JELEK KADIFE VESHURË

Nuk jam aspak i marrë

Një që mbahej për ateist, rrëshket buzë një gremine.

Rastësisht dora i kap një shkurre. I tmerruar, fillon të ulërijë dhe të kërkojë ndihmë:

“Zoti im, më shpëto!”

Një qetësi vrasëse e mbuloi në ato çaste tmerri. E ai vazhonte të ulërinte:

“O Zot më shpëto!”

U dëgjua një zë nga lartë:

“Kështu thonë të gjithë, kur janë në rrezik.”

“Unë jo, o Zot! Jam shumë i sinqert. Do t’u flas për ty të gjithëve. Do t’u besoj të gjitha porosive të tua!”, ngulte këmbë i rrezikuari.

“Fare mirë, atëherë lëshoj shkurren”, i tha Zoti.

“Të lëshoj shkurren? Nuk jam aspak i marrë!”

Një ëndërr

Një burrë dhe një grua rrinin pranë e pranë një dritareje të hapur dhe prisnin ardhjen e pranverës.

Gruaja i thotë burrit:

“Të dua. Je i bukur dhe i pasur, gjithmonë rri i veshur bukur.”

Burri i përgjigjet:

“Edhe unë të dua. Ke një mendje të mrekullueshme. Je tepër e çmuar për t’u mbajtur ndër duar. Je një këngë në ëndrrat e mia.”

Gruaja i kthehet e zemëruar:

“Më lërë, të lutem. Nuk jam në një mendje me ty. Nuk jam send që kalon në ëndrrat e tua. Jam një grua. Dua të më duash si grua, si nënë e fëmijëve që do të kemi.”

Dhe u ndanë.

Burri tha:

“Ja një ëndërr tjetër që u çua te retë!”

“Gruaja iu kthye:

“Çfarë të bësh me një burrë që të kthen në mjegull e ëndërr?”

Dy miqtë

Më i moshuari quhej Frank dhe ishte njëzet vjeç. Më i riu ishte Tedi, tetëmbëdhjetë vjeç. Rrinin gjithmonë bashkë. Ishin shumë miq që nga fëmijëria. Së bashku vendosën të shkonin ushtar. Në çastet e nisjes, i premtuan vetes dhe prindërve se do të kishin kujdes njëri-tjetrit.

Ishin të gëzuar kur u rregulluan në të njëjtin batalion.

Batalioni një ditë u dërgua në luftë. Ishte një luftë e tmerrshme, që zhvillohej në rërën e nxehtë të shkretëtirës. Për pak kohë Frank e Ted mbetën në fushat e mbrojtjes së aviacionit. Një mbrëmje erdhi urdhëri për të sulmuar armikun. Ushtarët përparuan për gjithë natën nën breshërinë e një zjarri prej ferri.

Në mëngjes batalioni u grumbullua në një fshat. Por Ted nuk ishte. Franku e kërkoi nga të gjitha anët, midis të plagosurve, midis të vdekurve. Gjeti emrin e tij në listën e të zhdukurve.

Iu paraqit komandantit:

“Kërkoj leje për të marrë mikun tim.”

“Është me shumë rrezik, iu përgjigj komandanti, - kam humbur mikun tënd, nuk dua të humbas edhe ty. Jashtë janë duke zbratur armë.”

Franku u nis menjëherë. Mbas disa orësh e gjeti Tedin të plagosur për vdekje. E ngarkoi mbi shpatulla. Por një ashkël e goditi. Rrëshkiti me trupin e tij gjer në kamp.

“A vlente dënimi yt me vdekje për të shpëtuar një të vdekur?”, i bërtiti komandanti.

“Po, - pëshpëriti, - sepse para se të vdiste, Tedi më tha: Frank, e dija se do të vije.”

Mishkonjat

Një nënë e re, e pajisur me një lopatëz gjuajtësemizash, ndiqte një mishkonjë të madhe që vinte rrotull nëpër dhomë.

Djali tre vjeç e gjysmë, e kap të ëmën prej fundit dhe i thërret:

“Lëre të jetojë!”

“Po përse, biri im, ajo mund të pickojë?”

“Sepse po na bën shoqëri.”

Të nxisim dhe të përhapim biznesin sportiv

Viti 2000 shënon në Berat fillimin e ndërtimeve të objekteve dhe qendrave të reja sportive. Ishte një fillim i vonuar i biznesit sportiv në Berat, por përsëri shumë i rëndësishëm. Qendrat dhe objektet sportive janë ndërtuar nga biznesmenët të cilët kanë vlerësuar ngritjen e tyre me qëllime të dyfishta; të krijojnë mjedise të bukura kalitjeje dhe argëtimi dhe pa shkëputur leverdinë e fitimin financiar.

Fakti që qendat sportive të ndërtuara janë bashkëkohore, tregon se biznesmenët kanë qenë të prirur nga qëllimi e dëshira që të jenë sa më funksionale dhe të tërheqin njerëz të shumtë. Sigurisht, jo të gjitha bizneset sportive suksesi e kanë njëlloj apo në një kohë. Biznesmenët që kanë ndërtuar minifutbolle ia kanë arritur këtij qëllimi; ndërsa ata që kanë ndërtuar palestra të forcës, vazhdojnë të mos e kenë frekuentimin e duhur. Kjo vjen sepse akoma ka koncepte, madje arrihet seri atje sa të flitet se këto në Berat janë të parakohshme (?!). Pra, nënçmohen vlerat që kanë ato në forcimin e shëndetit të njerëzve. Pa dyshim se do të vijë dita që, ashtu si në Tiranë e gjetkë, këto qendra do të gjallërohen. Për ngritjen e biznesit sportiv ka patur edhe vështirësi, megjithëse e përgjithshmeja është se ata nga ana e Bashkisë janë përkrahur. Kohët e fundit ka biznesmenë, të nxitur nga gjallëria e këtij lloji biznesi, që kanë ndërhyrë për të ndërtuar objekte sportive, por janë ndeshur në pengesa. Kështu është rasti i një biznesmeni që kërkon të ndërtojë një pishinë.

Duhet të kemi parasysh se përkrahja, stimulimi dhe përhapja e biznesit sportiv përbën një nga detyrat kryesore të institucioneve që i kanë këto kompetenca për lejen e ndërtimeve, sigurisht në bazë të ligjeve, sepse vetëm kështu do të bëjmë që ai ritëm i ngadalshëm zhvillimi, që ka qyteti ynë, të ndryshojë. Në të kundërt, biznesmeni atë qëllimin e tij do të realizojë, por jo në Berat, në një qytet tjetër.

Siç shihet në Berat biznesi sportiv privat e ka sfiduar shtetin. Ai brenda 3 viteve ka ngritur 9 objekte që shteti për më shumë se 12 vjet (1990-2002) jo vetëm që nuk ka ngritur asnjë objekt të ri sportiv, por edhe ato që kanë qenë, si këndi i lojërave me dorë, kompleksi sportiv, sheshet sportive të pallateve dhe të shkollave, u prishën, u zaptuan. Edhe dy angarët që janë përshtatur në palestra gjimnastike e boksi, janë në gjendje të mjerueshme. Me të drejtë vizitorët specialistë të këtyre sporteve, kur i kanë parë, janë befasuar me madhësinë e kubaturës së tyre dhe me gjendjen që ato kanë, ndaj edhe na kanë thënë: “Ju keni gjëra të bukura në Berat, por nuk dini t’i mbani”. Kanë të drejtë! Vlash Pambuku

Tepër i vonuar në hedhjen e tollombaces suaj kulturore, z.Kuka!

Në numrin 5 të “Lajmëtarit të Beratit”, zoti Kadri Kuka, Drejtor i Drejtorisë së Kulturës në Bashkinë e Beratit, krahas disa mendimeve për zhvillimin e kulturës në këtë qytet për të ardhmen, bën një ftesë të hapur për debat për njerëzit që punojnë në kulturë dhe për njerëzit e kulturës, pa dallim, qofshin të dëbuar për shkaqe të pastra politike nga institucionet e kulturës, qofshin të kërcënuar çdo ditë me dëbime po për shkaqe të tilla.

E falënderoj zotin Kadri Kuka, që për mendimin tim është një njeri i hapur dhe sikur të mos kishte frikë nga militantët partiakë, vërtetë do të kishte bashkëpunuar me artistë e njerëz të kulturës, pa dallimet idiote partiake, sepse të gjithë e dimë se kultura është një (natyrisht kultura e vërtetë) dhe krijohet nga njerëzit e kulturës pa dallim.

Që debati për kulturën të mos jetë thjesht një sfilatë në pasarellet e kollonave të gazetave, siç mund të paragjykohet edhe shkrimi i zotit Kadri, mendoj se në debat duhet të sjellin mendimet e tyre edhe drejtues të lartë te pushtetit vendor në Berat, kandidatë për kryetarë të bashkisë, këshilltarë të Bashkisë, të cilët marrin vendime për kulturën dhe është i mirëpritur në debat edhe Drejtuesi Monumental i Qendrës Kulturore të Beratit, që krahas hiçit të gjatë kulturor, do t’i bëjë vetëm një shërbim të ardhmes: Do të mbetet në inventarin e këtij qyteti si një Monument i Shkëlqyer i Paafëtësisë. Por... më duhet të pohoj me keqardhje se punët e kulturës gjatë këtyre viteve kanë vajtur për drejt. Ndaj, kur lexova mendimet e tua tek “Lajmëtarit” zoti Kuka, m’u kujtua Don Kishoti i Mançës i Servantesit dhe fjalët me të cilat i drejtohet Kalorësi i famshëm Sanço Pançës: “Pa hidhi një sy vetes, Sanço!”

Keni qënë, në fakt, me shans si drejtor i kulturës. Me fonde shumë më të mëdha se pararendësit, jo thjesht një përgjegjës zyre si pararendësit, por një drejtor drejtorie, me një mazhorancë dërrmuese në Këshillin e Bashkisë, me përmirësim të dukshëm të ligjit për autonominë lokale etj, etj.

Po çfarë risie i keni sjellë kulturës në Berat gjatë këtyre tre vjetëve, zoti Kuka?

Për mendimin tim pak, tepër pak.. Dhe në shumë drejtime keni sjellë edhe regres. Le të fillojmë me reformën në

institucionet e kulturës. Shumica e institucioneve të kulturës janë shumë më pak produktive se sa në diktaturë. Në letër dhe në bordero egziston Teatri i Estradës. Në skenë ai mungon prej vitesh. Fjala **shpërdorim** në këtë rast na vjen në ndihmë për politesë, kur mendojmë për fondet me miliona të dhënë për Teatrin e Estradës. Po kështu edhe për institucione të tjera inegzistente si Muzeu Historik, që promovon vend e pa vend vetëm historinë e errët të 50 viteve diktaturë, duke shkelur me të dy këmbët statusin e tij dhe të qëndrës kulturore dhe ligjin. Qendra Kulturore nuk është më qëndër kulturore. Nuk e di si e emërtoni ju në dokumentacionin tuaj. Gjithçka mund të jetë , vetëm qëndër kulturore jo. Aty marrëzia është pa limit, ka mbërritur deri tek trashëgimi i vendeve të punës nga një familjar tek tjetri.

Gjatë këtyre viteve kultura ka pësuar regres sidomos në paraqitjen e jashtme të qytetit tonë. Ju, edhe nëse nuk jeni inspirues i pllakave - logo të diktaturës të vendosura edhe në muret shekullorë të Kështjellës së Beratit, do të mbaheni mend si drejtor i kohës kur qyteti i vjetër u mbështoll me telefon të kuq për “t’u shitur” tek të huajt si qytet socialist, i viteve të partisë. U falet kjo tendencë veteranëve, por jo juve, që rrogën e madhe të drejtorit e keni nga taksat e të gjithë shqiptarëve dhe nga donacionet e dhuratat e Bashkimit Europian dhe SHBA, për të realizuar politikat e promovimit të kulturës së këtij qyteti dhe politikat e integritimit kulturor në botën e qytetëruar, të shkuara e zeza në të bardhë në programin e partisë tuaj dhe të miratuara ligjërisht nga Parlamenti Shqiptar.

Me propozimin tuaj gjatë këtyre viteve, Këshilli i Bashkisë ka çuar drejt vrimës së zezë miliona lekë, drejt vrimës së zezë që e ka emrin Qendra Kulturore e Beratit, pa asnjë projekt kulturor e artistik, ndonëse dihet se as një lek nuk jepet në tym, pa një projekt të detajuar e argumentuar. Cdo lek i taksapaguesve duhet t’u kthehet atyre në formën e artit, kulturës, mjedisit të përmisuar, cilësisë së shkollimit etj.

Më duhet t’ju them, zotëri i nderuar, se ju që në fillim e nisët keq. Ju e nisët reformën tuaj duke bërë, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës Kulturore, pushime nga puna për motive të pastra politike. Më pas sollët disa punonjës nga “klasa punëtore”, pa arsim dhe pa asnjë lidhje me kulturën. Po ato dite vendosët edhe bustin e Ushtarit në mes të qytetit më të vjetër të Shqipërisë. Pastaj shkatërruat Këshillin e Kulturës së Bashkisë duke formuar një tjetër këshill ilegal, për të cilin nuk kemi fare dijeni si banorë e taksapagues të këtij qyteti. (Do të respektonit një të drejtë themelore tonën, atë të informimit, nëse do të publikoni listën e Këshillit të Kulturës së Bashkisë)

Një drejtor kulture bashkie që nuk bën publike listën e anëtarëve të këshillit të kulturës së qytetit, që nuk bënë publike kërkesën për projekte kulturore në fillimviti, projektet fitues që do të financohen nga Këshilli i Bashkisë, për mendimin tim punon në ilegalitet, ose nuk punon fare.

Në ligjin për funksionimin e pushtetit vendor thuhet se pranë bashkive funksionojnë këshillat e kulturës, ku bëjnë pjesë personalitetet e artit, kulturës, shkencës të një qyteti. Aty sillen projekte kulturore, artistike, mjedisore, humanitare, të cilët diskutohen gjerësisht në këshill dhe pastaj drejtorja e kulturës ia propozon për njohje e miratim krytarit të bashkisë dhe me miratimin e këtij, i përcillen këshillit të bashkisë. Jam i sigurtë që këtë praktikë sa ligjore dhe demokratike, drejtorja juaj nuk e ka praktikuar ndonjëherë.

Ndër artistët, shkrimtarët, studjuesit vizionarët e politikave kulturore promovuese dhe integruese, banorë të Beratit, unë do të përmendja (U kërkoi falje atyre që e meritojnë dhe nuk po i përmend) : Shkrimtarin, përkthyesin, eseistin Balil Gjini, piktorin e talentuar, mjeshtrin e fotografisë artistike Bruno Ago, piktorin e njohur dhe menazherin e artit Kastriot Dervishi, publicistin dhe vizionarin Simon Vrusho, mjeshtrin e mjedisit të gjelbër Baftjar Kafexhiu, piktorin dhe restauratorin e njohur Agron Polovina, studjuesin e kulturës së traditës Agim Mehqemeja, muzikantët Neim Veizi dhe Agron Gjyzari, përkthyesin dhe njohësin e qytetërimit perëndimor Agim Lika, historianët Bedri Telegrafi dhe Ymer Kordha, përkthyesin, sociologun dhe veprimtaren e suksesshme të Ojq-ve Fitore Sulejmani, autorin e studjuesin Viktor Papa, inxhinjerin me grada shkencore Hazbi Shehu. A është ndonjëri nga personalitetet e sipërpërmendur anëtar i Këshillit të Kulturës së Bashkisë?

Nëse përgjigjia është negative, dhe e tillë është, atëherë me plot gojën mund t’ju them se regresi dhe dështimet tuaja si Drejtor i Drejtorisë së Kulturës e kanë bazën pikërisht këtu. Ju e keni parë kulturën me syze partiake, si kulturë që e prodhon pala socialiste dhe të tjerët janë thjesht konsumatorë të saj. Gabim i madh që nuk korrigjohet në fund të mandatit të pushtetit vendor, zoti Drejtor.

Kur përmenda atë punën e sfilatës që ju bëni në pasarelata e kollonave të gazetave, kam parasysh edhe një debat tjetër që ke hapur në një gazetë tjetër lokale, duke më ftuar mua publikisht dhe nominalisht. Unë, në respekt të lexuesit, t’u përgjigjja duke të shfaqur edhe mendimin tim për problemet që ju ngrini sot. Pas botimit të shkrimit tim, ju heshtët. Vazhduat punën tuaj tepër të mbyllur, ose tepër të hapur me megafon në gojë në mes të qytetit duke u bërë thirrje qytetarëve për të shkuar tek Sheshi i Dosave. Unë nuk kam përfytyruar ndonjëherë pozitë më qesharake për një drejtor kulture, se sa këtë.

Nëse institucionet që ju drejtoni ofrojnë art e kulturë, qytetarët dinë vetë ku të venë e ku të mos venë. Por ju, gjatë këtyre viteve u morët me veprimtari masive, herë-herë të politizuara, ku mungonte arti dhe kultura dhe mbizotëronte vulgariteti. Arti elitari, kultura e vërtete , në asnjë rast nuk erdhi në skenë gjatë viteve që ju drejtoni. Edhe Galeria e Artit “E. Lear”, që është shquar për veprimtari cilësore dhe ekspozim të artit, nga presioni juaj dhe vartësve të tu, kohët e

fundit ka ekspozuar edhe surrogato, duke fyer pulikun e zgjedhur të krijuar në vite. Edhe mjaft veprimtari të Bashkisë që duhet të kishin formën moderne të paraqitjes, komunikimit me publikun vendas dhe të huaj, kanë çaluar në këtë drejtim, sepse ju nuk e keni kryer detyrën tuaj të shumfishtë, që ka të bëjë me gjithë shprehjen me kulturë të Bashkisë dhe institucioneve që varen prej saj. Herë-herë ndihej dora e ndonjë pseudoveterani, në vend të dorës suaj kulturore në mjaft veprimtari të Bashkisë.

Pse? Sepse ju nuk keni qënë në lartësinë e detyrës suaj. Nuk keni patur një këshill kulture që do t'i jepte tempin e vërtetë artistik e kulturor tërë jetës së këtij qyteti.

Natyrisht, u ka munguar dhe oponenca, për të cilën çdo shoqëri moderne ka nevojë dhe çdo shoqëri primitive e mënjanon dhe e urren.

Platforma e shprehur në shkrimin tuaj, krahas donkishotizmit, ka edhe elementë realistë. Po pse nuk e keni vënë në jetë, qoftë edhe pjesërisht, gjatë këtyre tre viteve të "mbretërimit" tuaj kulturor? Mos vallë është thjesht një tollombace elektorale, plot ngjyra?

Yzedin Hima

Spektakle të këngës, bukurisë dhe teatrit në lagjen "10 Korriku"

Në mungesën e përgjithshme të shfaqjeve të teatrit të estradës, të funksio-nimit të institucioneve kulturore e artistike në qytetin e Beratit, në sokakët e lagjes "10 Korriku" u zhvilluan disa veprimtari kul-turore e artistike. Artistë janë vogëlushët e shkollës 8-vjeçare, ndërsa organizatorë gjimnazistët, motrat më të rritura. Rrugicat janë mbushur plot e përplot me fëmijë, gjimnazistë, gjyshe e prindër të papunë, të cilët kanë ndjekur me interes spektaklet. Sezonin veror e hapi festivali i interpretuesve të këngës, ku morën pjesë 8 këngëtare vogëlushe. Nuk vunë muzikë shoqëruese në magnetofon, sepse nuk kishte drita. U interpretuan këngë të muzikës së lehtë me mjaft mjeshtëri. Juria e përbërë nga gjimnazistët: Ana Gaxho, Luiza Pasku, Evgjëni Vjeshta, Gloria Pasku, shpalli fituese vogëlushen Enxhi Sinjari, 9-vjeç, me këngën "Cërr, cërr, cërr bën telefoni". Nga fondi i mbledhur në rrugicë (çdo vogëlush vuri 50 lekë), fituesja mori një glob me trëndafil si dhuratë, blerë tek linja 150.

Pas festivalit të interpretuesve u zhvillua Mis Rrugica 2003, ku morën pjesë: Megi Toska, Sindi Bega, Megi Qojle, Ani Sulejmani, Ueda Telhaj, Lueda Bitri, Enxhi Sinjari, Sabrina Shehu, Klea Vojka, Valentina Karakashi, Nidia Bega, bukuroshe të vogla. Mis Rrugica 2003 u shpall zonzjusha Ani Sulejmani, klasa e 3-të, aktualisht banon në Amerikë; shoqëruesja e parë e Mis-it u shpall vogëlushja Megi Qojle dhe Mis buzëqeshja u shpall Klea Vojka.

Këto veprimtari po ndiqen nga Teatri i Rrugicave, që po shfaqet paradite dhe pasdite në sokakët e lagjes "10 Korriku". Loja e aktorëve të vegjël është spontane, e freskët befasuese. Nuk do të ishte çudi sikur një anëtar i këshillit të Bashkisë të propozonte në Këshillin Bashkiak që disa fonde të mos shkonin drejt institucioneve që flenë gjumë, por të vinin në mbështetje të artistëve e orgnizatorëve të rrugicave të lagjes "10 Korriku"

Lajmëtari

"Etika është elementi numër një i dinjitetit të një gazete"

Z.Agim Mehqemeja,
kryeredaktor i gazetës "Lajmëtari i Beratit"

Duke qënë një beratas i shqetësuar për mbarëvajtjen e qytetit në të gjitha fushata e jetës, të kulturës e të gjithë veprimtarive të tjera, mbi bazën e një konkurrence të ndershme, e kam ndjekur me interes daljen e gazetës suaj, si një ogur të ri, të mirë, si një hapësirë të re të fjalës së lirë, por dhe në shërbim të një opinionit të shëndetshëm publik.

Kontribuoni që qyteti të dalë nga plogështia, të zgjohet nga letargjia, të distancohet nga zvetënimimi, një rrezik ky që gati po e përpin. Këto që sapo përmenda janë sëmundje që kurohen me terapi mentale, jo me terapi radikale, që të mund të shpëtojmë nga rreziqet fatale.

Por ajo që më shtyn t'ju shkruaj është një çështje tjetër, që nga rutina e punës, sensacionet e blifet që rëndom i ngjiten shtypit, ju pa e kuptuar mund të kaloni kufijtë e etikës, e cila, përtej shkrimeve objektive, subjektive, duke u bashkuar me trajtime spekulative, do të cënonte emrin e mirë të gazetës, do të largonte lexuesit e kulturuar e të qytetëruar, gjë që do të shndërrohej në bumerang të misionit fisnik që gazeta ka marrë përsipër. Kam përshtypjen se ju mungon redaktori i etikës, z.Agim.

Le të ketë gazeta shkrime të forta në argumente, kurajo në fshikullimin e së keqes, ide interesante, sugjerime për rrugëdaljen, le të ketë kritikë, kritikë, kritikë të bazuar dhe të saktë të adresuar, edhe etika të mos u mungojë asnjëherë. Nuk më kujtohet se ku kam lexuar: "Etika është elementi numër një i dinjitetit të një gazete"

Elio Kondi

Refleksion

E lexova me mjaft kujdes letrën e zotit Elio Kondi dhe e falenderoj thellësisht së pari për vëmendjen që i kushton gazetës sonë, së dyti për interesin dhe kujdesin që tregon për “lajmëtarin” në drejtim të etikës që është vërtetë kostumi i zgjedhur me të cilën gazeta del përpara publikut. Gati-gati e ndjeva zotin Elio si pjesëtar të stafit të kësaj gazete. Dhe, në tërë këtë përjetim prekës e konsiderojmë tërheqjen e vëmendjes si këshillë të një miku të vjetër. Pa dyshim, kësaj gazete kurrë nuk do t’i mungojë etika siç nuk i mungon lexuesit të saj, qytetarit, të kulturuar të Beratit.

Agim Mehqemeja